



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 57, datë 24.04.2019

MBI

KËRKESËN PËR DORËHEQJE TË GJYQTARIT ARBEN ZEFI

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në një analizë të bërë dispozitave të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokuroreve”, lidhur me kërkesën për dorëheqje të gjyqtarit Arben Zefi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kërkesë e regjistruar me aktin nr. 111 prot., datë 10.01.2019, në kushtet kur gjyqtari, ka ushtruar të drejtën e ankimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit kundër vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit,

VENDOSI:

1. Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës i gjyqtarit Arben Zefi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të bëhet pas marrjes së vendimit nga Kolegji i Posaçëm të Apelimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**